



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 505/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Nehat Idrizi kryesues, Vllastimir Dimic dhe Ferit Osmani, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Fryma e Re (FER) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Kryesuesit të Adnan Jupolli, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat me nr. A-505 dhe A-506, të datës 13.12.2010, të subjektit politik Fryma e Re (FER)

Arsyetim

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar 2 (dy) ankesa, me numër A-505 dhe A-506, të datës 13.12.2010 e paraqitur nga FER kundër Kryesuesit Adnan Jupolli në të cilat pretendohet se :

Më datë 12.12.2010 rreth orës 10:00 në QV 1923E 01r në Shkollën e Mesme “Hoxhë Kadri Prishtina” vëzhguesi i FER-it Dardan Misini ka raportuar se tre persona kanë hyrë në këtë VV dhe kanë votuar së bashku me arsyetimin se njëri prej tyre ka qenë i shtyrë në moshë dhe analfabet. Vëzhguesi i FER-it e ka paraqitur rastin tek komisionari Adnan Jupolli mirëpo nuk ka ndërmarr asgjë.

Po ashtu në ditën e zgjedhjeve më datë 12.12.2010 rreth orës 18:00 vëzhguesi i FER-it Dardan Misini nga QV 1923 E/a në Shollën e Mesme ekonomike “Hoxhë Kadri Prishtina”, ka raportuar se komisionari Adnan Jupolli e ka ndaluar që të dërgonte ankesë për arsye se në të njëjtën kohë dy persona kishin votuar disa herë me radhë.

Ne mbështetje te pretendimeve, parashtruesi i ankesave nuk ka bashkangjitur asnjë prove.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) dhe neni 6.3 parashohin si vijon:

3.6 (c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

6.3. Me qëllim të lehtësimit të shyrimit të ankesave, kryesuesi i panelit mund të vendose ta bej bashkimin e ankesave që perbajne ne vete çeshtje te ngjashme, paneli vendimmarrës i trajton ato si kur te ishin një ankese.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi te gjitha shkresat e lendes gjeti se:

- ankesat janë të pabazuara

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesat e subjektit politik FER, kane mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullsi gjatë votimit si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar. Për këto arsye, dhe duke u bazuar ne dispozitat e lartpërmendura si dhe ne kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 505/2010 më datën 16.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Nehat Idrizi

